



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PATOS**

Nr. \_\_\_\_ Prot

Patos më, \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2022

Shtojcë III: FORMATI APLIKIMIT PER PROJEKTET

Aplikuesi (*)	Bashkia Patos
Data e aplikimit (*)	27.05.2022
Titulli i projektit (*)	Rikonstruksion i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtim i palestrës.
Programi i projektit (*)	Programi buxhetor 09120 “Arsimi Baze”
Data e fillimit të projektit (*)	Sipas grafikut të punës: 10 muaj afat për realizimin e punimeve Sipas grafikut të prokurimit max i kohës për mbylljen e procedurës së prokurimit dhe fillimin e punës 85 ditë.
Data e mbarimit të projektit (*)	Brenda 1 viti projekti realizohet plotësisht dhe fillon përdorimin e tij.
Përshkrimi i projektit (*)	-Vendndodhja e objektit të investimit: Objekti ndodhet në lagjen “Naftëtari”, është një shkollë shumë e rëndësishme e qytetit pasi ka një numër të madh nxënësish dhe ka tendenc në rritje të numrit të tyre pasi dhe lagjia në të cilën ndodhet shkolla është në qendër të qytetit dhe në rritje të numrit të banorëve. -Objekti është ndërtuar rreth viteve '60 dhe është me themele të vazhduara me gurë me mure me tulla, e mbuluar me soletë dhe me cati sipër. I gjithë objekti është i suvatuar me llac të përzier, dyshemeja me pllaka gres, dyer dhe dritare druri. Objekti ndodhet në gjendje jo të mirë fizike, ka plasaritje, lagështirë në mure, territori është i pasistemuar dhe ka të pazgjidhur disiplinimin e ujrave sipërfaqësorë. Me mbylljen e punimeve për këtë objekt rikonstruktohen të gjitha shkollat e qytetit gjë e cila do ishte shume pozitive për të filluar me investime të reja.

	<p>-Punimet që do të kryhen në objekt janë në kuadrin e rikonstruksionit të objektit dhe ndërtimin e një palestre të re. Punimet përfshijnë prishje muresh të brendshëm në disa pjese të cilat shërbejnë për të riformatuar planimetrinë dhe riorganizimin e funksioneve të shkollës, do të ketë suvatime, nivelime, shtrim pllakash, vendosje dyersh dritare pasi aktualisht janë të degraduara. Do të kryhet izolimi i soletës sipër si dhe rikonstruksioni i catise e cila është e degraduar. Do të krijohen hapësira të reja të munguara aktualisht në shkollë si terrent sportive, palestra dhe laboratorë. Po ashtu në cdo kat do të vendosen tualetet të cilat ishin të munguara. Në këtë mënyrë do të ketë një mësim cilësor për 18 klasa që ka aktualisht shkolla duke krijuar dhe klasa të tjera për numrin në rritje të studentëve.</p> <p>-Në projekt do të ketë panduse për kalimin e personave me aftësi të kufizuar të cilat do të aksesojnë shkollën dhe klasat për të zhvilluar mësim normalisht, sipas standarteve</p> <p>-Bashkëlidhur ndodhet grafiku i punimeve dhe grafiku i prokurimit. Sipas grafikut të punës: 10 muaj afat për realizimin e punimeve. Sipas grafikut të prokurimit max i kohës për mbylljen e procedurës dhe fillimin e punës 85 ditë</p> <p>-Nëpërmjet aplikimit dhe zbatimit të këtij projekti zgjidhen përfundimisht problemet që ka aktualisht shkolla dhe zona duke bërë të mundur ardhjen e një numri sa më të madh nxënësish dhe i jep zgjidhjen përfundimtare të gjitha shkollave të qytetit. Shkolla në fjalë ndodhet në një lagjje të rëndësishme, në qendër të qytetit, duke u bërë i mundur rikonstruksioni i shkollës nxënësit nuk do të largohen më nga shkolla për kushte jot ë mira të infrastrukturës.</p> <p>-Në këtë shkollë aktualisht janë 352 nxënës të shpërndarë në 18 klasa dhe klasat janë 2 klasa për cdo parallel. Me rikonstruksionin e shkollës dhe me trendin që ka zona në rritje të numrit të banorëve pasi vijnë shumë banorë të rinj nga zonat përreth, nga fshatrat do të bëhet e mundur që të gjithë fëmijët e kësaj zone të përqëndrohen në një shkollë të vetme dhe most ë shpërndahen për shkak të kushteve jot ë mira</p>
--	--

	<p>nëpër shkolla. Projekti parashikon rreth 27 klasa, 3 laboratore, 1 bibliotekë dhe të gjitha hapësirat e tjera ndihmëse për të zhvilluar një mësim sa më të mirë dhe cilësorë.</p> <p>-Aktualisht objekti është pronësi e Bashkisë Patos sipas Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, ndodhet në zonën kadastrale 2890, me nr, pas 7/101, truall + ndërtesë, ndërtesë 3 katëshe.</p>
Qëllimi dhe objektivat (*)	<p>Qëllimi i projektit është që të ofrojë kushte bashkëkohore për zhvillimin e mësimit dhe tërheqja e nxënësve për të ardhur në këtë shkollë dhe mos të largohen më për kushte jo të mira të zhvillimit të mësimit. Objektivat:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Mësim cilësor sipas standarteve</li> <li>2.Rritje e numrit të nxënësve që ndodhen në këtë zonë</li> <li>3.Krijimi i kushteve bashkëkohore duke i bërë të gjitha shkollat e qytetit njësoj me kushte dhe me shërbim cilësor.</li> <li>4.Krijimi i hapësirave të mundëshme për stërvitje dhe kryerje të aktiviteteve sportive pasi afër ndodhet dhe stadiumi i qytetit dhe palestra do të shërbejë jo vetëm për stërvitje gjatë shkollës dhe mësimit por edhe për aktivitete pasditeve për të gjithë të rinjtë e qytetit.</li> </ol>
Numri i përfituesve (*)	<p><b>Aktualisht në shkollën “Muhamet Shehu” shkojnë nxënës nga lagjja “Naftëtari”, Lagjja “Dukas” dhe “Kuqari</b>, aktualisht numri i banorëve që përfshijnë këto blloqe shkon afërsisht 10800 banorë. Student që shkojnë në shkollë janë 360 nxënës, por ka një tendenc në rritje të numrit të nxënësve dhe sidomos pas rikonstruksionit ku do të vijnë dhe shumë nxënës të tjerë të zonës që aktualisht shkojnë në shkolla private si pasoj e gjendjes jo shumë të mirë të shkollës.</p> <p>Aktualisht në shkollë ka 27 mësues të cilët japin mësim në shkollë.</p>
Sipërfaqe e trajtuar (*)	<p>Sipërfaqe e parcelës që zhvillohet: 3320m<sup>2</sup>  Sipërfaqe e parcelës e zënë nga struktura: 1380m<sup>2</sup>  Sipërfaqe e katit përdhe: 840m<sup>2</sup>  Sipërfaqja e katit parë: 840m<sup>2</sup>  Sipërfaqja e katit dytë: 840m<sup>2</sup>  Projekti parashikohet të ndërtohet i gjithi brenda një viti, jo i ndarë në lote. Bashkia do të bashkëfinancojë</p>

	në masën 10% të vlerës së plotë të projektit dhe i ka parashikuar këtë vlerë për vitin 2020 nga të ardhurat e trashëguara.
Rendi prioritar (*)	Numri 1. Ky projekt është shumë prioritar për Bashkinë Patos.
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Për sa i përket mirëmbajtjes së objektit Bashkia Patos mirëmban objektet nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve si pjesë e bashkisë, ku cdo vite drejtoria e shërbimeve parashikon në buxhetin e vetë fondin për mirëmbajtjen e shkollave. Menjëherë pas periudhës së garancisë së objektit që ka vlerën 5% e shumës totale të projektit cdo fund viti shkollor bashkia harton preventivat me problemet dhe nevojat që ka shkolla dhe objekti. Po ashtu dhe nderhyrje të herëpërhershme sa herë që drejtoria e shkolles paraqet kërkesë për ndonjë problematik të caktuar në ndricim, në pjesët hidrosanitare etj.
Fondet e kërkuara nga MAS (*)	Vlera totale e projektit sipas preventivit: <b>95,394,560.01 (nëntëdhjetë e pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë pikë zero një) lekë</b> Vlera e bashkëfinancimit nga njëësia e qeverisjes vendore: <b>14,309,184.01 (katërmëdhjetë milion e treqind e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër pikë zero një) lekë</b> Vlera që kërkohet për financim: <b>81,085,376 (tëtdhjetë e një milion e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë)</b> sipas rregullit ku fondi që kërkohet është e barabartë me koston totale të projektit minus vlerën dysheme të detyrueshme të bashkëfinancimit nga njëësia e qeverisjes vendore sipas Shtojcës 1 të këtij vendimi.
Kontributi i detyrueshëm në bashkëfinancim nga njëësia e qeverisjes vendore (*)	Bashkia Patos nisur nga fakti që zbatimi i projektit sipas grafikut të punimeve dhe atij të prokurimit shkon dhe në vitin 2023 bashkëfinancimin prej 15% të vlerës së projektit e cila do të financohet nga qeverisja vendore sipas kushtit dhe shtojcës nr.1 të vendimit do ta mbulojë të shpërndarë në 2 vitë 2022 dhe 2023. Bashkëlidhur gjendet dhe shkresa e nënshkruar nga kryetari ku merr përsipër vlerën dysheme të bashkëfinancimit për këtë aplikim.

Financim nga donator (*)	Nuk ka financim nga donator për këtë objekt
Financime të tjera	Nuk ka burime të tjera financimi
Kostoja totale e projektit (*)	Kostoja e objektit sipas preventivit: 95,394,560.01 lekë
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	PO
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Projekti ka një kosto të preventivuar për sa i përket investimit dhe ndërhyrjeve që do të kryhen në objekt. Po ashtu për sa i përket përfitimit ka përfitim i gjithë komuniteti pasi janë tre lagje që cojnë nxënësit në këtë shkollë, Lagjja Naftëtari, Lagjja Dukas dhe Kuqari. Po ashtu pas kryerjes së investimit do të rritet dhe numri nxënësve të cilët aktualisht nuk shkojnë në atë shkollë pasi nuk ka cilësi të mirë nga infrastruktura.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (Opsionale)	PO
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Për sa i përket anës mjedisore, objekti do të reduktoj kostot e harxhimit pasi do të bëhet me materiale bashkëkohore duke reduktuar kostot e energjisë elektrike për ngrohje-ftohje, do të ketë një impakt pozitiv në mjedis pasi nuk do të ketë ndotje.
Deklarime (*)	Aplikuesi deklaron se: <ul style="list-style-type: none"> <li>i. Projekti është gati për zbatim (I disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) Pas daljes fitues për marrjen e fondit bashkia menjëherë mund të filloj procedurën e prokurimit dhe të vazhdoj procedurën për zbatimin e projektit.</li> <li>ii. Projekti është pjesë e projekteve të parashikuara si prioritare në buxhetin e bashkisë për vitin 2022</li> <li>iii. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues ka siguruar për pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit në fuqi.</li> <li>iv. Janë zbatuar cmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përlllogaritjen e kostos dhe vlerës financiare të projektit.</li> </ul>
Dokumentet teknike (*)	Dosja e aplikimit përmban: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Projektin teknik/projektin e zbatimit</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Preventivin</li> <li>- Grafikon e prokurimit dhe grafikon e zbatimit të punimeve</li> <li>- Relacionet teknike</li> <li>- Specifikime teknike</li> <li>- CD</li> </ul>
Koordinatat e projektit (*)	Eshte bere planvendosja e objektit me koordinatat sipas sistemit të gjeoreferencuar.
Foto-Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe të gjendjes ekzistuese të objektit
Pamje 3 Dimensionale (*) i detyrueshëm	Imazhe për gjendjen përfundimtare të objektit pas ndërhyrjes, rendera.

**KRYETARE**  
Rajmonda **BALILAJ**

*Konceptoi:*  
*Konfirmoi:*